

Informator për hapat e ekzaminimit të gjirit për gratë e Kryeqytetit

Informator për hapat e ekzaminimit
të gjirit për gratë e Kryeqytetit



Drejtoria e Shëndetësisë
Komuna e Prishtinës










1. Hapi i parë për vajzat dhe gratë e moshës 18-40 vjeçare

Nëse jeni nën moshën 40 vjeç, rekomandohet që të bëni një vizitë te mjeku familjar në qendrën tuaj më të afërt të mjekësisë familjare. Më pas, do të udhëzoheni nga mjeku familjar për të bërë një ultrazë në qendrën radiologjike në KPSH. Sipas rekomandimeve të radiologut, mund të udhëzoheni për mamografi nëse është e nevojshme. Në mungesë të shenjave objektive apo dyshimit për prani të qelizave kancerogjene, do të liroheni për të vazhduar kontrollet sistematike te mjeku familjar, pa indikacion për përsëritje të kësaj procedure deri në moshën 40 vjeç (përfshijë rastet kur vëreni ndonjë shenjë si këto):

- Gungë e re në gji ose në zonën e sqetullës.
- Trashje ose ënjtje e një pjese të gjirit.
- Irritim ose lëkurë e gropëzuar në gjoks.
- Skuqje ose lëkurë e thatë në zonën e thithit ose të gjirit.
- Tërheqje e thithit ose dhimbje në zonën e thithit.
- Rrjedhje nga thithi apo maja e gjirit që nuk është qumështi i gjirit, duke përfshirë gjak, qelb apo çdo lëng të pazakonshëm.
- Çdo ndryshim në madhësinë ose formën e gjirit.
- Dhimbje në çdo zonë të gjirit.

Vetë-ekzaminimi i gjirit

Duke filluar nga mosha 20 vjeç, vajzave dhe grave u duhet folur mbi përfitimet dhe kufizimet e vetë-ekzaminimit të gjirit. Gratë duhet të dinë se si duket dhe ndihet normalisht gjiri i tyre dhe duhet të raportojnë çdo ndryshim që vërejnë te mjeku, sapo ta zbulojnë atë. Gjetja e një ndryshimi në gji nuk do të thotë domosdoshmërisht që kemi të bëjmë me kancer, pasi mund të ketë shumë shkaqe të tjera për këtë. Koha më e përshtatshme për të kryer vetë-ekzaminimin e gjirit është kur gjinjtë nuk kanë dhimbje ose nuk janë të enjtur. Çdo herë që një grua vëren ndryshime në gjirin e saj, duhet të kërkojë menjëherë këshillën e mjekut.



1. Hapi i parë për vajzat dhe gratë e moshës mbi 40 vjeçare

Nëse jeni mbi moshën 40 vjeçare atëhere ju rekomandojmë që të lajmëroheni në qendrën tuaj më të afërt të Mjekësisë Familjare, për të bërë ultrazë apo mamografi.

Pas rezultateve të ultrazërit apo mamografisë dhe konsultimit me radiologun atëhere mund të ju propozohet për të vazhduar konsultimet në Klinikën e Kirurgjisë Torakale për tu konsultuar me specialistin e kësaj fushe (klo vlen edhe për vajzat/gratë nën moshën 40 vjeçare).

*Shërbimi i ultrazërit dhe mamografisë ofrohet në kuadër të QKMF-së, QMF V në Dardani dhe në QMF- në Veternik.

Vizitat për mamografi janë falas dhe nuk kërkojnë caktim paraprak të terminit gjatë gjithë vitit, përveç në muajin tetor (Muaji Rozë). Gjatë muajit tetor, është e nevojshme të caktohet një termin paraprakisht, duke telefonuar në numrin 038/221-924. Gjatë këtij muaji nuk është i nevojshëm udhëzimi nga mjeku familjar."

*Shërbimi i Radiologjisë ofrohet çdo ditë pune nga ora 07:00-13:00



2. Hapi i dytë

Klinika e Kirurgjisë Torakale

Kur një pacient referohet nga Kujdesi Parësor Shëndetësor për një vizitë më të detajuar në Klinikën e Kirurgjisë Torakale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ai duhet të paraqitet fillimisht në Ambulantën Specialistike, e cila ofron shërbime nga ora 08:00 deri në 14:00, çdo ditë pune.

Gjatë vizitës në Ambulantën Specialistike, bëhet vlerësimi i pacientit. Procesi diagnostikues përfshin:

- Ekografia (USG) e gjinjëve;
- Biopsia




Gjithashtu, kryhet **CNB (biopsia me bërthamë)**, e cila është një procedurë mjekësore që përdoret për të marrë një mostër indi nga një zonë e dyshimtë, si një gjëndër ose masë, për të diagnostikuar sëmundje.

Çdo material i marrë, qoftë me CNB apo me biopsi të hapur, dërgohet për ekzaminim histopatologjik te mjeku patolog, për të vendosur diagnozën përfundimtare.

Nëse pas diagnostikimit ka indikacion për ndërhyrje kirurgjike, pacienti procedohet dhe vendoset në listën e ndërhyrjeve kirurgjike. Në rastet kur pacienti diagnostikohet me sëmundje malinje, i jepet përparësi dhe trajtimi kirurgjik kryhet brenda 2-3 javësh.

Pas ndërhyrjes kirurgjike, pacienti hospitalizohet për 2-3 ditë dhe monitorohet gjendja e tij. Pas përmirësimit të gjendjes, pacienti lirohet për trajtim ambulator. Pastrimi, trajtimi dhe shërimi i plotë i plagës, si dhe heqja e penjeve, bëhen në Ambulantën Specialiste, dhe më pas pacienti referohet për trajtim të mëtejshëm te onkologu.



3. Hapi i tretë

Klinika e Onkologjisë

Pacientët referohen në Klinikën e Onkologjisë zakonisht pasi është konfirmuar diagnoza, konkretisht pas ekzaminimeve imazherike, citologjisë dhe/ose biopsisë.

Sipas stadeve të sëmundjes, pacientët mund t'i jenë nënshtruar trajtimit kirurgjik (mastektomi/quadrantektomi), ose mund të jenë kandidatë për trajtim neoadjuvant (terapi specifike/kimioterapi para trajtimit kirurgjik).

Pacientët referohen kryesisht nga Kirurgjia Torakale dhe/ose nga klinika të tjera.

Në Klinikën e Onkologjisë, pacientët paraqiten në konsiliumin multidisciplinar, i cili përbëhet nga dy ose tre onkologë klinikë, një radioterapeut dhe një kirurg torakal. Qëllimi i këtij konsiliumi është përcaktimi i skemës së trajtimit në përputhje me stadin e sëmundjes dhe gjendjen e pacientes, sipas protokolleve bashkëkohore të trajtimit. Konsiliumet mbahen çdo ditë në ambientet e klinikës, prej orës 11:00.

Format e trajtimit për neoplazitë e gjirit janë:

- **Kimioterapia**
- **Terapia e cakut (target terapia)**
- **Hormonoterapia**
- **Trajtimi me bisphosphonate**
- **Radioterapia**

Kohëzgjatja e trajtimit varion nga lloji i këtij të fundit.

- Kimioterapia aplikohet në formë ciklike, zakonisht çdo tre javë, gjithnjë sipas specifikave dhe rekomandimeve të mjekut përgjegjës.

- Hormonoterapia zgjat për një periudhë më të gjatë, zakonisht 5 deri në 10 vite. Ajo jepet në formë tabletash për përdorim ditor dhe injeksione nën lëkurë që aplikohen një herë në muaj. Përzgjedhja e hormonoterapisë bëhet në bazë të moshës së pacientes, statusit hormonal dhe faktit nëse pacientja është në menopauzë apo jo.

- Radioterapia aplikohet zakonisht pas përfundimit të kimioterapisë. Ky proces realizohet nga një ekip i përbërë nga mjeku radioterapeut, fizikanti mjekësor dhe teknikët e radioterapisë. Radioterapia aplikohet në seanca ditore, sipas përshkrimit të mjekut.

Efektet anësore të trajtimeve menaxhohen nga mjekët e klinikës. Pas përfundimit të trajtimeve, pacientët ndiqen në mënyrë të rregullt me ekzaminime laboratorike dhe imazherike nga mjekët specialistë të klinikës.

* Në kuadër të Klinikës së Onkologjisë çdo ditë pune ofrohet terapi individuale dhe grupe me psikologjen klinike prej orës 08:00-13:00.

Përgatitur nga:

Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Shëndetësisë
Dr. Izet Sadiku, Arbnora Sahiti

Shërbimi i Radiologjisë në QKMF Prishtinë.
Dr. Edita Bajraktari

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
Elvir Azizi

Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Dr. Hajdar Osmanaj

Klinika e Kirurgjisë Torakale
Dr. Nazmi Kolgeci, Dr. Selman Ajvazi, Dr. Driton Tolaj, Yllka Krasniqi

Klinika e Onkologjisë
Dr. Ilir Kurtishi

Action for Mothers and Children
Albiona Beha, Labërie Carreti Sylejmani

Recenzent: Dr. Vjollca Kadolli Halili

Prishtinë, 2025



Drejtoria e Shëndetësisë
Komuna e Prishtinës



AMC Action for Mothers
and Children